

VENDIM
Nr. 631, datë 24.7.2013

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË EKUADORIT PËR
HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE DIPLOMATIKE, ZYRTARE OSE SPECIALE TË
REPUBLIKËS SË EKUADORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Ekuadorit për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit të Republikës së Shqipërisë dhe diplomatike, zyrtare ose speciale, të Republikës së Ekuadorit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË EKUADORIT PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE DIPLOMATIKE,
ZYRTARE OSE SPECIALE TË REPUBLIKËS SË EKUADORIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Ekuadorit (më poshtë të quajtura “Palët Kontraktuese”),
të nisur nga dëshira për të lehtësuar hyrjen, daljen dhe lëvizjen e shtetasve të tyre,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetasit e Republikës së Shqipërisë, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe shërbimi dhe shtetasit e Republikës së Ekuadorit, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, zyrtare apo speciale mund të hyjnë pa viza në territorin e secilës Palë Kontraktuese dhe mund të qëndrojnë atje për një periudhë prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh brenda një afati prej 180 ditësh nga data e hyrjes.

Neni 2

1. Shtetasit e njëres Palë Kontraktuese, mbajtës të pasaportave diplomatike, zyrtare apo speciale, në rastin e Ekuadorit, dhe pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, në rastin e Shqipërisë, të punësuar në misione diplomatike, konsullore dhe organizata ndërkombëtare që kanë selitë e tyre në territorin e Palës Kontraktuese tjetër, kanë të drejtë të hyjnë pa viza në territorin e vendin të Palës tjetër Kontraktuese gjatë kohës që janë në funksionet e tyre zyrtare.

2. Dispozitat e nenit 1 do të aplikohen, gjithashtu, për anëtarët e familjeve të tyre që banojnë me ata në të njëjtën banesë dhe posedojnë pasaporta të vlefshme diplomatike, zyrtare apo speciale për Ekuadorin dhe pasaporta diplomatike dhe shërbimi për Shqipërinë.

Neni 3

Shtetasit e njërës Palë Kontraktuese, mbajtës të pasaportave të përcaktuara në nenin 1 do të hyjnë, largohen dhe kalojnë transit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në çdo pikë kufitare, të caktuar për kalim ndërkombëtar.

Neni 4

1. Shtetasit e njërës Palë Kontraktuese, mbajtës të pasaportave, të specifikuar në nenin 1, do të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregullat e tjera të Palës tjetër Kontraktuese gjatë qëndrimit në territorin e asaj Pale.

2. Kjo marrëveshje nuk do të kufizojë të drejtën e Palëve Kontraktuese, të refuzojnë hyrjen apo të anulojë qëndrimin e një shtetasi të Palës tjetër që mund ta konsiderojnë si person non grata.

Neni 5

1. Me qëllim mbrojtjen e sigurisë kombëtare, paqen dhe rendin social dhe shëndetin e qytetarëve të tyre, Palët Kontraktuese do të kenë të drejtë të pezullojnë pjesërisht ose tërësisht zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

2. Palët Kontraktuese do të njoftojë menjëherë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për vendimin mbi pezullimin tërësisht ose pjesërisht të kësaj marrëveshjeje ose rihyrjen e saj në fuqi.

Neni 6

1. Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike ekzemplarët e pasaportave, të specifikuara në nenin 1, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje.

2. Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën për ndryshimet e këtyre ekzemplarëve 60 (gjashtëdhjetë) ditë para se këto ndryshime të hyjnë në fuqi.

3. Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë ekzemplarët e pasaportave, të specifikuara në nenin 1, të rejat apo të ndryshuarat, duke përfshirë të dhënat në lidhje me përdorimin e tyre të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë para se këta ekzemplarë të futen në qarkullim.

Neni 7

Debatet që mund të lindin në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 8

Kjo marrëveshjeje lidhet për një kohë të pacaktuar, secila Palë Kontraktuese mund ta anulojë këtë marrëveshjeje në çdo kohë, duke i dërguar njoftim me shkrim Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja pushon së vepruari 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e marrjes nga Pala tjetër e këtij njoftimi.

Neni 9

Kjo marrëveshjeje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes të notës diplomatike të fundit me anën e së cilës Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën se kanë plotësuar të gjitha kushtet e parashikuara në legjislacionin e tyre për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Bërë në Vjenë, datë 4.6.2013, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, spanjolle dhe angleze, duke qenë të dyja tekstet me vlerë të njëjtë. Në rast mosmarrëveshjes në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Vili Minarolli

Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
EKUADORIT

Juan Diego Stacey Moreno

Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i

Republikës së Shqipërisë në Austri

Republikës së Ekuadorit në Austri